VENDIM
Nr. 541, datë 13.6.2013

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LANDFILLIT "BAJKAJ"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i landfillit "Bajkaj".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Këshillit të Qarkut të Vlorës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për tokë bujqësore, me një vlerë të përgjithshme prej 20 865 792 (njëzet milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy) lekësh.

4. Shuma e përgjithshme e shpronësimit prej 20 865 792 (njëzet milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy) lekësh, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve".

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 596 000 (pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të përballohen nga Këshilli i Qarkut të Vlorës.

6. Shpronësimi të fillojë më 20.6.2013.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Këshillit të Qarkut të Vlorës.

8. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me këshillin e qarkut të Vlorës, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit të landfillit "Bajkaj" në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimeve, që do t'u vihet në dispozicion nga Këshilli i Qarkut të Vlorës, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sarandë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit të landfillit "Bajkaj" në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sarandë dhe Këshilli i Qarkut të Vlorës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KËSHILLI I QARKUT VLORË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LANDFILLITIT NË FSHATIN PALAVLI, KOMUNA VERGO

Nr.	PRONARI		ZK	Nr. i pasurisë	Sip. m^2	Çmimi m^2	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri, mbiemri							
1	Kadri	Dauti	2864	663	399	645.6	257,594	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Petrit	Dauti	2864	664	239	645.6	154,298	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Eqerem	Dauti	2864	665	773	645.6	499,049	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Rabije	Raça	2864	666	356	645.6	229,834	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Sihat	Raça	2864	667	310	645.6	200,136	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Idriz	Raça	2864	668	528	645.6	340,877	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	Nesip	Raça	2864	669	679	645.6	438,362	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Bastri	Raça	2864	670	2076	645.6	1,340,266	Konfirmuar nga ZVRPP-ja

9	Vesel	Sinani	2864	671	860	645.6	555,216	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Nazie	Sinani	2864	672	1009	645.6	651,410	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	Taip	Sinani	2864	673	1076	645.6	694,666	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
12	Teki	Dauti	2864	676/677	4038	645.6	2,606,933	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	Sinan	Kuçi	2864	678	892	645.6	575,875	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
14	Ago	Kuçi	2864	679	1859	645.6	1,200,170	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	Nedin	Kuçi	2864	680	2349	645.6	1,516,514	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
16	Shahin	Haderi	2864	681	7123	645.6	4,598,609	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
17	Arif	Haderi	2864	683	3404	645.6	2,197,622	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
18	Shpetim	Dauti	2864	725	22	645.6	14,203	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
19	Teno	Dauti	2864	725	2215	645.6	1,430,004	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
20	Daut	Alinani	2864	725	2113	645.6	1,364,153	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	TOTALI				**32320**		**20,865,792**	